



FTESË PËR PJESËMARRJE NË TAKIMIN KONSULTUES PËR PËRCAKTIMIN E FUSHAVE TË PËRPARËSIVE NË KUADËR TË THIRRJES SË TRETË PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NË BASHKINË KUKËS

Bashkia Kukës në kuadër të bashkëpunimit me Programin Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2), një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe e zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD), ka filluar procesin e përgatitjes së Thirrjes së Tretë Publike për Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC-të).

Hapi i parë i këtij procesi është konsultimi me OShC-të i tematikave që do të shërbejnë për të vendosur përparësitë e thirrjes. Për këtë qëllim, bazuar në dokumentet strategjike ekzistues, Bashkia **Kukës** ka përzgjedhur prioritetet më emergjente të cilat kanë nevojë të konsultohen dhe validohen në bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile.

Të gjitha OshC-të e interesuara për t'u bërë pjesë e këtij procesi, janë të ftuara të marrin pjesë në konsultimin publik në përzgjedhjen e përparësive që do të organizohet në datë **17 Korrik 2023**, ora **11:00** në **ambientin e American Corner**.

Më poshtë do të gjeni rendin e ditës dhe çështjet kryesore për diskutim:

- Prezantim i projektit ReLOaD2;
- Diskutimi / konsultimi i përparësive të propozuara për Thirrjen e Tretë publike për OshC-të në Bashkinë Kukës, si vijon:

1. Mundësi zgjerimi për terrenet dhe aktivitetet sportive dhe kulturore

- 1.1 Terrene sportive dhe kulturore për të rinj apo kënde lojërash për fëmijë
- 1.2 Përmirësim i infrastrukturës shkollore, palestrave dhe oborreve

2. Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit

- 2.1 Ndërgjegjësim dhe edukim mjedisor i komunitetit për mbrojtjen e ambientit si dhe pasuritë natyrore të zonës.
- 2.2 Informim dhe ndërgjegjësim i komunitetit nëpërmjet veprimeve konkrete për ndarjen e mbetjeve në burim.

3. Fuqizimi i turizmit në bashkinë Kukës

- 3.1 Turizmi eco-alternativ për promovimin e territorit, vlerave historike dhe kulinarisë
- 3.2 Promovimi i vlerave artistike dhe kulturore në Bashkinë Kukës.

4. Çështjet sociale

- 4.1 Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për fëmijët me aftësi ndryshe
- 4.2 Fuqizim dhe ofrim shërbimesh për moshën e tretë

5. Rritja e përfaqësimit në vendimmarrje

- 5.1 Nisma konkrete me përdorimin e mekanizmave institucional dhe ligjorë për forcimin e demokracisë vendore në bashkinë Kukës.